



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr 610/01-23085/20

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:					
PËR/ZATO:		Anëtarët e Kuvendit Komunal			
CC:					
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:		Zahir Doda, drejtor i DAK-së			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Informatë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/21			
Nr. i zyrës:		Lokacioni:		Data:	
Br. kancelarije:	-	Kucni:	Administrata	Datum:	17.09.2020
Room No.:		Extension:	Komunale	Date:	



INFORMATË

Filimi i Vitit të Ri shkollor 2020 /2021

Viti i ri shkollor 2020 - 2021 ka filluar më 14 shtator 2020, sipas kalendarit shkollor të MASH-it, i hartuar në përputhje me rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID 19, dhe sipas vendimit për fillimin e vitit të ri shkollor të ndarë në dy faza. Në fazën e parë janë përfshirë niveli parashkollor dhe klasat 1,2,3,6 dhe 10 sipas skenarit A (me prezencë në shkollë), ndërsa në shkollat tona kanë filluar edhe klasat 4 dhe 5, po ashtu sipas skenarit A, pra me prezencë në shkollë, pasi në të gjitha shkollat kishte hapësirë të mjaftueshme dhe në përputhje me vlerësimin e Task forcës në nivel të DKA-së dhe shkollave përkatëse.

Faza e dytë, do të fillon më 21 shtator, në të cilën fazë do të përfshihen klasat, 7, 8, 9, 11 dhe 12, sipas skenarit B, pra dy ditë në shkollë dhe tri ditë mësim online dhe në distancë.

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK), edhe pse në kushte dhe rrethana jo të zakonshme, edhe sivjet i ka filluar me kohë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/21, duke i respektuar në tërësi udhëzimet dhe vendimet e MASH e IKShPK për fillimin e mësimin në kushte pandemie.

Fillimisht është bërë planifikimi i regjistrimit të fëmijëve para fillor e atyre në klasat e para. Bazuar në raportet e 12 shkollave fillore amë, këtë vit shkollor janë regjistruar gjithsej 456 fëmijë para fillor prej tyre 446 në Shkollat fillore e të mesme të ulëta të shpërndarë në 39 grupe dhe 10 fëmijë të tjerë të sistemuar në QEAP "Agimi", ndërkaj sivjet janë regjistruar gjithsej 490 fatosë në klasat e para të shpërndarë në 27 paralele, ose 9 më shumë krahasuar me një vit më parë (481). Po ashtu, është bërë edhe planifikimi i regjistrimit të nxënësve në klasat e X-ta, në 2 shkollat e mesme: në Gjinnazin "Skënderbeu" dhe SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka". Në Gjinnazin "Skënderbeu" sivet janë regjistruar 187 nxënës, ndërsa ishin planifikuar 224 nxënës të ndarë në 7 paralele:

1. **Drejtimi Shkenca Natyrore**, 4 paralele me 97 nxënës të regjistruar
2. **Drejtimi Shkenca Shogërore-Gjuhësore**, 3 paralele me 90 nxënës.

Ndërkaq, në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" janë regjistruar gjithsej 163 nxënës në 11 paralele, ndërkaj kanë qenë të planifikuar të regjistrohen gjithsej 312 nxënës të ndarë në 4 Drejtimet:

1. **Elektroteknikë me profilet:**
 - Elektronikë industriale,
 - Teknik i Informatikës
 - Instalues Elektrikë me nga 1 paralele,

2. Ekonomi me profilet:

- Kontabilitet dhe tatime dhe
- Tregti me shumicë dhe Pakicë me nga 1 paralele,

3. Makineri me profilet:

- Instalues i ngrohjes e klimatizimit dhe ujësjellësit e kanalizimit (2 paralele),
- Trafik rrugor,
- Automekanik dhe
- Metalpunues, me nga 1 paralele dhe

4. Juridik me profilin:

- Juridik, administratë dhe shërbime të zyrës me 1 paralele.

Sa i përket kuadrit arsimor, DAK gjithashtu me kohë e ka publikuar konkursin për plotësimin e vendeve të lira, ndërkohë që janë zhvilluar të gjitha procedurat e rekrutimit dhe selektimit për disa nga pozitat e lira. Në QEAP "Agimi" janë plotësuar gjithsej 7 pozita: 2 edukatore, 3 motra edukatore dhe 2 punëtorë teknik, ndërkohë që janë plotësuar edhe vendet e lira për dy mësimdhënës të mesimit klasor në shkollën e Bajnicës, paralele ndarë e SHFMU "Nazmi Osmani" dhe 1 mësimdhënës (zëvendësim) në SHFMU "7 Shtatori" në Bëgracë.

Në të gjitha shkollat janë bërë përgatitjet higjienike e teknike, ndërkëq është bërë edhe dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore. Shkollat janë furnizuar me mjete higjienike si dezinfektues, sapun, e detergjentë të tjerë, ndërkëq për secilën shkollë janë siguruar edhe termometrat për matjen e temperaturës së nxënësve. Për të ndihmuar fillimin e vitit të ri shkollor MASH ka publikuar një dokument (Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mesimit në kushte të pandemisë COVID 19) me qëllim të organizimit të mesimit sipas skenarëve A dhe B dhe C, ku prioritet është ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativ arsimor sipas kornizës së Kurikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë për tre nivelet të arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID – 19.

Këtë vit shkollor kanë filluar punën 22 institucione shkollore të nivelit AF dhe AMU prej tyre 18 shkolla të plota 1-9 dhe 3 të tjera ku mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-5 ndërkëq, në një shkollë mësimi zhvillohet vetëm për klasat 1-4. Sivjet mësimi nuk ka filluar në shkollën e Gjurgjedellit pasi kishin mbetur vetëm 4 nxënës, për të cilët është siguruar transporti.

Vlen të theksohet se nxënësit e shkollës “Qamil Ilazi” në Kacanik të Vjetër dhe ata të shkollës “Idriz Seferi”, paralelja e ndarë në Kovacec, mësimin e kanë nisur në objekte të reja. Të dy shkollat kanë hapësirë të mjaftueshme, ndërsa janë të ndërtuara me standarde bashkëkohore dhe moderne. Objekti shkollor në Kacanik të Vjetër është financuar me mjete të MASH, e po ashtu ministria e ka bërë edhe furnizimin me inventar, ndërsa objekti në Kovacec është ndërtuar dhe financuar nga buxheti i komunës e po ashtu nga buxheti i komunës është bërë edhe furnizimi me inventarë shkollor. Ndërkohë që akoma nuk janë bërë investimet kapitale të planifikuara për renovimet dhe riparimet e nevojshme në objektet shkollore, të cilat ka qenë detyrë të kryhen para fillimit të vitit të ri shkollor. Investimet janë vonuar përkundër përgatitjeve me kohë nga drejtoria e arsimit dhe inicimit të procedurave nga Zyra e Prokurimit, për shkak se disa operator e kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre dhe janë ankuar në Zyrën e Organit Shqyrtues të Prokurimit..

Për fillimin e mbarë të vitit shkollor në të gjitha shkollat janë themeluar edhe Task Forca, me qëllim të zbatimit të udhëzimeve dhe rekomandimeve të MASH dhe MSH. Task forca e themeluar duke vepruar në përputhje me kompetencat e veta ka ndërmarr masat anti COVID 19 duke përfshirë edhe vendosur sistemin e komunikimit me prindër, nxënës, mësimdhënësit e Task forcën në nivel komune. Po ashtu, shkollat duke vepruar sipas udhëzimeve të MASH kanë përgatitur hapësirat e dhomave mësimore për numër të përgjysmuar të nxënësve për klasat me numër të madh nxënësish duke vendosur një nxënës në një bankë e po ashtu janë shenjëzuar hapësira e oborrave dhe hapësira e korridoreve për mbajtjen e distancës prej 1.5 metra, ndërkohë që janë ekspozuar edhe shumë poster me porosi se si të mbrohemi nga COVID 19 në ambientet shkollore etj.

Me qëllim të përgatitjeve sa më të mira për fillimin e vitit të ri shkollor në kushte pandemie, në të gjitha shkollat janë mbajtur trajnime me mësimdhënësit për përdorimin e platformave digjitale, ndërkohë që me kohë janë siguruar edhe ditarët e punës e materiale tjera të nevojshme. Edhe sivjet, sikurse edhe viteve të më hershme janë siguruar dhe shpërndarë edhe librat për nxënës të cilat edhe për këtë vit shkollor, qeveria e vendit, përmes MASH dhe shtëpive botuese të kontraktuara, i kanë furnizuar falas nxënësit e dy niveleve, I-V dhe VI- IX si dhe klasat parafillore.

- Numri i nxënësve në vitin shkollor 2020 – 2021

Në bazë të të dhënave, në shkollat e Komunës sonë kemi këtë gjendje statistikore:

Në nivelin 0 (para fillor) sivjet janë regjistruar gjithsej 456 fëmijë, 16 më pak krahasuar me një vit më parë (472) prej tyre 446 fëmijë të shpërndarë në gjithsej 39 grupe në shkollat fillore dhe 10 të tjerë të përfshirë në QEAP “Agimi”, ndërsa që sivjet në grupin e fëmijëve para fillor nuk është paraqit asnjë në shkollën e Kotinës dhe vetëm 1 në atë të Strazhës.

Në nivelin I (fillor), gratë këtij viti shkollor mësimet janë duke i vijuar gjithsej 2468 nxënës që krahasuar me një vit më parë (2466 nxënës), del se sivjet në këtë nivel janë duke vijuar 2 nxënës më shumë.

Tabela 1. Numri i nxënësve nga klasa I deri V sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	Gjithsej
“Ermin Duraku”	164	158	156	153	159	790
“Idriz Seferi”	63	49	47	64	42	265
“Kadri Zeka”	53	50	56	54	44	257
“Jusuf Gërvalla”	32	41	41	26	30	170
“Qamil Ilazi”	46	35	56	50	49	236
“Nazmi Osmani”	25	32	40	35	36	168
“Ali Asllani”	26	36	29	34	41	166
“7 Shatori”	27	23	38	30	37	155
“Dituria”	15	12	14	10	11	62
“Agim Bajrami”	22	21	18	21	18	100
“Gafurr Luma”	16	18	14	14	18	80
“Naim Frashëri”	1	2	4	3	9	19
Gjithsej	490	477	513	494	494	2468

Ndërkaq, në nivelin 2 (Mesëm të Ulët) nga klasa e VI deri në klasën e IX, mësimet sivjet i kanë filluar gjithsej 1964 apo 36 më pak, krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2019/2020 që në këtë nivel ishin gjithsej 2000 nxënës.

Tabela2. Numri i nxënësve nga klasa VI deri IX sipas shkollave

Shkolla	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
“Emin Duraku”	148	153	166	162	629
“Idriz Seferi”	40	64	47	60	211
“Kadri Zeka”	46	36	57	34	173
“Jusuf Gërvalla”	32	35	29	34	130
“Qamil Ilazi”	47	50	45	44	186
“Nazmi Osmani”	31	40	40	42	153
“Ali Asllani”	43	46	37	33	159
“7 Shatori”	27	37	23	36	123
“Dituria”	16	12	13	14	55
“Agim Bajrami”	17	14	19	13	63
“Gafurr Luma”	21	14	15	19	69
“Naim Frashëri”	4	3	5	1	13
Gjithsej	472	504	496	492	1964

Nga kjo që u tha më lartë, del se numri i përgjithshëm i nxënësve në të dy nivelet (1 dhe 2) fillor dhe të mesëm të ultë në këtë fillim viti shkollor është 4432 ose 34 më pak, përdërisa vitin e kaluar në këto dy nivele ishin 4466.

Tabela 3. Numri i nxënësve nga klasa I deri IX sipas shkollave

Shkolla	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	Gjithsej
“Emin Duraku”	164	158	156	153	159	148	153	166	162	1419
“Idriz Seferi”	63	49	47	64	42	40	64	47	60	476
“Kadi Zeka “	53	50	56	54	44	46	36	57	34	430
“Jusuf Gërvalla”	32	41	41	26	30	32	35	29	34	300
“Qamil Ilazi”	46	35	56	50	49	47	50	45	44	422
“Nazmi Osmani”	25	32	40	35	36	31	40	40	42	321
“Ali Asllani”	26	36	29	34	41	43	46	37	33	325
“7 Shatori”	27	23	38	30	37	27	37	23	36	278
“Ditura”	15	12	14	10	11	16	12	13	14	117
“Agim Bajrami”	22	21	18	21	18	17	14	19	13	163
“Gafur Luma”	16	18	14	14	18	21	14	15	19	149
“Naim Frashëri”	1	2	4	3	9	4	3	5	1	32
Gjithsej	490	477	513	494	494	472	504	496	492	4432

Në tabelën Nr.3 shihet se numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë vit shkollor është 4432 që krahasuar me vitin shkollor paraprak 2019-2020 (4466), ky numër është më i vogël për 34 nxënës. Edhe viteve të kaluara kishte rënie të numrit të nxënësve, krahasuar me vitet paraprake. P.sh. vitin e kaluar shkollor 2019 - 2020 kanë vijuar 4466 nxënës apo 51 më pak krahasuar me një vit më parë (4527) apo në vitin 2018-2019 që kanë vijuar 4527 apo 100 më pak krahasuar me një vit më parë (2017-2018) që kishin vijuar 4627 eij.

Tabela 3a. Numri i nxënësve të regjistruar nga I – IX sipas viteve

Viti shkollor	Numri i nxënësve I - IX	Më pak krahasuar me një vit më parë
2020 - 2021	4432	34
2019 - 2020	4466	51
2018 - 2019	4527	100
2017 - 2018	4627	167
2016 - 2017	4794	E tjera

Në nivelin 3 (Mesëm të Lartë) në 2 shkollat e mesme, në Gjimnazin “Skënderbeu” dhe SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka” këtë vit shkollor 2020-2021 mësimet i vijojnë gjithsej 1157 nxënës që krahasuar me një vit më parë, 2019-2020 (1258nxënës), sivjet ky numër është më i vogël për 101.

Sikurse në shkollat nëntëvjeçare edhe në dy shkollat e mesme, ka pas rënie të numrit të nxënësve sipas viteve.

Tabela 3b. Numri i nxënësve të regjistruar në dy shkollat e mesme sipas viteve

Viti shkollor	Numri i nxënësve X, IX dhe XII	Më pak krahasuar me një vit më parë
2020 - 2021	1157	101
2019 - 2020	1258	216
2018 - 2019	1474	59
2017 - 2018	1533	34
2016 - 2017	1567	E tjera

Në Gjimnazin “Skënderbeu” numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar është këtë vit shkollor është 674 (vitin e kaluar 728) ose 54 më pak dhe në SHMP “Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka sivjet janë regjistruar 483, ndërsa vitin e kaluar ishin 530 nxënës apo 47 më pak.

Tabela 4. Numri i nxënësve sipas klasave në 2 shkollat e mesme.

Shkolla	X	XI	XII	Gjithsej
Gjimnazi "Skënderbeu"	187	221	266	674
SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"	163	142	178	483
Gjithsej	350	363	444	1157

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr.04-610/01-23085/20
Kaçanik, 29.09.2020

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29 Shtator 2020, pos tjerash, u ;

INFORMUA

1. Me Aktivitetin e zhvilluar të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës-DAK -Për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, në bazë të dhënave të prezantuara në Informatën për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, hartuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës.

2. Pjesë përbërse e kësaj shkrese, është materiali më tekstin e mëtejme:” Informatë për fillimin e Vitit të Ri shkollor, 2020/2021, e përmbledhur në gjithsej : 5 faqe / Lënda: 01Nr. 04-610/01-23085/20.

Më këtë Shkresë njoftohet:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Mërseli